

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	00 Nr.21/2025	Data: 31.01.2025	

Kuvendi i Komunës, në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika d) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale në nenit 17 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme Komunale, neni 17 pika 6 Rregullores QRK Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, në mbledhjen e mbajtur me datë 31.01.2025 merr këtë :

V E N D I M
PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT 00.NR.186/2024
PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM
TË PRONËS TË PALUAJTSHME TË KOMUNËS PËRMES SHPREHJES SË
INTERESIT

1. SHFUQIZOHET, Vendimi i Kuvendit të Komunës 00 Nr.186/2024 i datës 27.12.2024 për themelimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës së Istogut paluajtshme përmes shprehjes së interesit.
2. Shfuqizimi i këtij vendim vjen si rezultat i rekomandimit nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal MAPL, me arsyetimin se për dhënie e pronës së paluajtshme përmes formës së shprehjes së interesit përkatësisht sipas nenit 17 paragrafi 6 përcakton që për secilin vendim paraprak të Kuvendit të Komunës formohet komisioni vlerësues për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme.
3. Ky Vendim hynë në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale ,si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit të tij në faqen zyrtare të Komunës dhe për zbatimin e tij do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Kadastër Pronë dhe Gjeodezi
4. Me kopje të këtij vendimi të njoftohen : Kryetari i Komunës, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, MAPL, Drejtoria për Kadastër Pronë dhe Gjeodezi dhe një kopje mbetet në arkivin e Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit
 z. Enver Rugova

E. Rugova



00 Nr./Br. 039 - 16 II
 Nr. i faq/Br. str. 01
 Data/Datum 06 / 02 2025
 ISTOG • ISTOK